



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Albkos Safety” të datës 14.06.2025 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi, servisi aparateve kundër zjarrit” me nr. të prokurimit 616-25-5122-1-3-6, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Albkos Safety” të datës 14.06.2025 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi, servisi aparateve kundër zjarrit” me nr. të prok. 616-25-5122-1-3-6.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Albkos Safety” (tutje “parashtruesi”) me datë 14.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi, servisi aparateve kundër zjarrit” me nr. të prok. 616-25-5122-1-3-6.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1. – “Në dosjen e tenderit janë përfshirë sasi të pasakta të aparateve që kërkohet të servisohen”.

P.2. – “Në dosjen e tenderit janë kërkuar 80 copë aparate P-6 kg dhe 12 copë P-9 kg, por nuk është kërkuar asnjë dokumentacion teknik minimal, siç është certifikata e konformitetit ose standardit”.

Lidhur me pretendimet ankimore është gjetur se lidhur me P.1. sasitë janë përcaktuar nga njësia kërkuuese dhe janë të sakta ndërsa lidhur me P.2. nuk mund të shtohen kërkesa të reja në DT sepse kjo do të ishte në kundërshtim me nenin 6 dhe 7 të LPP. Kërkesat aktuale janë të mjaftueshme për të realizuar kontratën në mënyrë efikase dhe efektive.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.06.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.